

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 2

Inventarët

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij Standardi është të përcaktojë trajtimin kontabël për inventarët. Një çështje kryesore në kontabilitetin për inventarët është shuma e kostos që duhet të njihet si një aktiv dhe të mbartet deri në njohjen e të ardhurave përkatëse. Ky Standard jep udhëzime mbi përcaktimin e kostos dhe njohjen e mëposhtme të saj si një shpenzim, përfshirë ndonjë zhvlerësim deri në vlerën neto të realizueshme. Ai gjithashtu, jep udhëzime mbi formulat e kostos që përdoren për të caktuar koston e inventarëve.

Objekti

- 2 Ky standard zbatohet për të gjithë inventarët, me përjashtim të:
- (a) [fshirë]
 - (b) instrumentet financiare (shih SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja dhe SNRF 9 Instrumentet financiare*); dhe
 - (c) aktivet biologjike që lidhen me veprimtarinë bujqësore dhe prodhimin bujqësor në pikën e të korrave (shih SNK 41 *Bujqësia*).
- 3 Ky Standard nuk zbatohet për matjen e inventarëve që mbahen nga:
- (a) prodhuesit e produkteve bujqësore dhe pyjore, të prodhimit bujqësor pas të korrave dhe të mineraleve e produkteve minerare, për sa kohë ato maten me vlerën neto të realizueshme në pajtim me praktikën e miratuar në këto sektorë. Kur këta inventarë maten me vlerën neto të realizueshme, ndryshimet në këtë vlerë njihen në fitim ose humbje në periudhën e ndryshimit.
 - (b) komisionarët apo tregtarët e mallrave të cilët i matin inventarët e tyre me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes. Kur këta inventarë maten me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes, ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot e shitjes, njihen në fitim ose humbje në periudhën e ndryshimit.
- 4 Inventarët e përmendur në paragrafin 3(a) maten me vlerën neto të realizueshme në disa faza të caktuara të prodhimit. Për shembull, kjo ndodh kur koren dhe vilen bimët dhe pemët bujqësore ose kur nxirren mineralet dhe shitja është e siguruar përmes një kontrate të ardhshme ose një garancie qeveritare, ose kur ekziston një treg aktiv dhe rreziku i mos shitjes së mallit është i pa pandjeshëm. Këta inventarë përjashtohen vetëm nga kërkesat për matjen, që jepen në këtë Standard.
- 5 Komisionarët-tregtarë janë personat të cilët blejnë ose shesin mallra për të tjerët ose për llogarinë e tyre. Inventarët e përmendur në paragrafin 3(b) kryesisht blihen me qëllim shitjen në të ardhmen e afërt dhe për të krijuar fitim nga luhajtjet e çmimit ose nga marzhi komisionar. Kur këta inventarë maten me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes, ato përjashtohen vetëm nga kërkesat për matjen, që jepen në këtë Standard.

Përkufizimet

- 6 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:
- Inventarët janë aktive:*
- (a) të mbajtur për shitje në rrjedhën normale të biznesit;
 - (b) në procesin e prodhimit për këto shitje; ose
 - (c) në formën e materialeve apo furnizimeve që do konsumohen gjatë procesit të prodhimit ose ofrimit të shërbimeve.
- Vlera neto e realizueshme* është çmimi i shitjes i vlerësuar me çmuarje në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë.)

- 7 Vlera neto e realizueshme i referohet shumës neto që një njësi ekonomike parashikon të realizojë nga shitja e inventarit gjatë rrjedhës normale të biznesit. Vlera e drejtë pasqyron çmimin me të cilin një transaksion i rregullt për të shitur të njëjtin inventar, në tregun kryesor (apo më të favorshëm) për këtë inventar, do të ndodhte midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Vlera e parë është një vlerë specifike e njësisë ekonomike; ndërsa vlera e fundit nuk është. Vlera neto e realizueshme për inventarët nuk mund të barazohet me vlerën e drejtë minus kostot për shitje.
- 8 Inventarët përfshijnë mallrat e blera dhe të mbajtura për rishitje, përfshirë për shembull, mallrat e blerë nga një shitës me pakicë dhe të mbajtura për rishitje, ose tokën apo aktive të tjera afatgjata materiale që mbahen për rishitje. Inventarët përfshijnë gjithashtu produktet e gatshme të prodhuara ose prodhimin në proces të realizuar nga një njësi ekonomike si dhe materialet e furnizimet që presin të përdoren në procesin e prodhimit. Shpenzimet e bëra për të përmbushur një kontratë me një klient që nuk japin rritje të inventarëve (ose aktiveve brenda fushëveprimit të një tjetër standardi) kontabilizohen në përputhje me SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*.

Matja e inventarëve

- 9 **Inventarët maten me shumën më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme.**

Kosto e inventarëve

- 10 **Kosto e inventarëve përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale.**

Kosto e blerjes

- 11 Kosto e blerjes së inventarëve përfshin çmimin e blerjes, taksat e importit dhe tatime të tjera (përveç atyre që njësia ekonomike i rikuperon nga autoritetet tatimore) dhe transportin, trajtimin dhe kosto të tjera që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes së produkteve të gatshme, materialeve dhe shërbimeve. Zbritjet tregtare, rabatet dhe zëra të tjerë të ngjashëm, zbriten gjatë përcaktimit të kostove të blerjes.

Kosto e transformimit

- 12 Kostot e transformimit të inventarëve përfshijnë kostot e lidhura drejtpërdrejt me njësitë e prodhimit, siç është puna e drejtpërdrejtë. Gjithashtu, ato përfshijnë një shpërndarje sistematike të shpenzimeve të përgjithshme fikse dhe variabël të prodhimit që kryhen gjatë transformimit të materialeve në produkte të gatshme. Shpenzimet e përgjithshme fikse të prodhimit janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat mbeten relativisht të pandryshueshme pavarësisht vëllimit të prodhimit, si për shembull, amortizimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të fabrikës, dhe pajisjeve dhe aktiveve me të drejtë përdorimi të përdorura në procesin e prodhimit dhe kostot e drejtimit të administrimit të fabrikës. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabël janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat ndryshojnë në mënyrë direkte, ose thuajse direkte, me ndryshimin e vëllimit të prodhimit, si për shembull, materialet indirekte dhe puna indirekte.
- 13 Shpërndarja e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit fikse në kostot e transformimit bazohet në kapacitetin normal të pajisjeve të prodhimit. Kapaciteti normal është prodhimi që pritet të arrihet mesatarisht gjatë një numri periudhash apo sezonesh në kushte normale, duke marrë në konsideratë humbjen e kapacitetit që rrjedh nga mirëmbajtja e planifikuar. Niveli aktual i prodhimit mund të përdoret nëse ai përfaqëson me kapacitetin normal. Shuma e shpenzimeve të përgjithshme fikse e shpërndarë për çdo njësi prodhimi nuk rritet si pasojë e prodhimit të ulët ose kur linja e prodhimit nuk punon. Shpenzimet e përgjithshme të shpërndara njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer. Në periudhat e prodhimit të lartë në mënyrë jonormale, shumën e shpenzimeve të përgjithshme të pandryshueshme të prodhimit e shpërndarë për çdo njësi të prodhimit zvogëlohet, kështu që inventarët nuk maten me kosto më të lartë. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabël shpërndahen për çdo njësi prodhimi bazuar në përdorimin faktik të pajisjeve të prodhimit.
- 14 Një proces prodhimi mund të rezultojë në prodhimin njëkohësisht të më shumë se një produkti. Ky është rasti, për shembull, kur prodhohen produkte të përbashkëta ose kur ka një produkt kryesor dhe një nënprodukt. Kur kostot e transformimit të secilit produkt nuk janë të identifikueshme veç e veç, ato shpërndahen midis produkteve mbi baza racionale dhe të qëndrueshme. Për shembull, shpërndarja mund të

mbështetet në vlerën relative të shitjeve të çdo produkti ose në fazën e procesit të prodhimit kur produkti bëhet i identifikueshëm veças, apo në përfundim të prodhimit. Shumica e nënprodukteve nga natyra janë jo-materiale. Në këtë rast ato shpesh maten me vlerën neto të realizueshme dhe kjo vlerë zbritet nga kosto e produktit kryesor. Për rrjedhojë, vlera kontabël e produktit kryesor nuk ndryshon ndjeshëm nga kosto e tij.

Kosto të tjera

- 15 Kostot e tjera përfshihen në koston e inventarëve vetëm deri në shkallën që ato kryhen për t'i sjellë inventarët në vendndodhjen dhe kushtet aktuale. Për shembull, mund të jetë e përshtatshme që në koston e inventarëve të përfshihen shpenzimet e përgjithshme jo-prodhuese ose kostot e projektimit të produkteve për klientë të veçantë.
- 16 Shembuj të kostove të përjashtuara nga kostoja e inventarit dhe që njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato janë kryer janë:
- (a) shumat jonormale të materialeve hedhurinë, kostove të punës ose kosto të tjera të prodhimit;
 - (b) kostot e magazinimit, përveç rasteve kur këto kosto janë të nevojshme gjatë procesit të prodhimit përpara fillimit të një faze të mëtejshme të prodhimit;
 - (c) shpenzimet e përgjithshme administrative që nuk kontribuojnë në sjelljen e inventarëve në kushtet dhe vendndodhjen e tyre aktuale; dhe
 - (d) kostot e shitjes.
- 17 SNK 23 *Kostot e huamarrjes*, identifikon disa rrethana kur kostot e huamarrjes përfshihen në koston e inventarëve.
- 18 Një njësi ekonomike mund t'i blejë inventarët në kushtet e shlyerjes së shtyrë. Kur marrëveshja përmban në fakt një element financimi, ky element, për shembull, diferenca midis çmimit të blerjes për kushtet normale të kreditimit dhe shumës së paguar, njihet si një shpenzim për interesa gjatë periudhës së financimit.
- 19 [Fshirë]

Kosto e prodhimit bujqësor të vjelë nga aktivet biologjike

- 20 Sipas SNK 41 *Bujqësia*, inventarët, të cilët përbëhen nga prodhimi bujqësor që një njësi ekonomik ka vjelë nga aktivet e saj biologjike, maten në njohjen fillestare me vlerën e tyre të drejtë minus kostot e çmuara të pikës së shitjes në pikën e vjeljes. Kjo është kosto e inventarëve me këtë datë, për zbatimin e këtij Standardi.

Teknikat për matjen e kostos

- 21 Në qoftë se rezultatet përafrohen me kostot, si teknika të matjes së kostos së inventarëve, për lehtësi mund të përdoren metoda e kostos standarde ose metoda e shitjes me pakicë. Kostot standarde marrin në konsideratë nivelet normale të materialeve, të furniturave, punën, efikasitetin dhe shfrytëzimin e kapacitetit. Ato shqyrtohen rregullisht dhe po qe se është e nevojshme, ndryshohen duke marrë parasysh kushtet aktuale.
- 22 Metoda e shitjes me pakicë përdoret shpesh në sektorin e shitjes me pakicë për të matur inventarët të cilët përbëhen nga një numër i madh artikujsh që ndryshojnë shpejt dhe kanë marzh fitimi të ngjashëm dhe për të cilët përdorimi i metodave të tjera të kostos është i pazbatueshëm. Kosto e inventarit përcaktohet duke zbritur nga vlera e shitjeve të inventarit marzhin bruto në një përqindje të përshtatshme. Përqindja e përdorur merr në konsideratë inventarin, çmimi i të cilit është ulur poshtë çmimit fillestar të shitjes. Shpesh për secilin departament të shitjes me pakicë përdoret një përqindje mesatare.

Formulat e kostos

- 23 **Kosto e inventarëve të artikujve që nuk janë të ndër shkëmbyeshëm rregullisht dhe të produkteve apo shërbimeve të prodhuara dhe të ndara veç për projekte të veçanta do të shpërndahet duke përdorur identifikimin specifik të kostove të tyre individuale.**
- 24 Identifikimi specifik i kostos do të thotë që kosto të veçanta ju ngarkohen elementeve të identifikuar të inventarit. Ky është trajtimi i përshtatshëm për artikujt të cilët janë veçuar për një projekt të veçantë, pavarësisht faktit nëse janë blerë apo prodhuar. Megjithatë, identifikimi specifik i kostove është i papërshtatshëm kur ka një numër të madh artikujsh të inventarit të cilët janë të ndër shkëmbyeshëm rregullisht. Në këto rrethana mund të përdoret metoda e zgjedhjes së atyre artikujve që mbeten në inventarë, duke kaluar efektet e paracaktuara në fitim ose humbje.

- 25 **Kosto e inventarëve, përveç atyre të trajtuara në paragrafin 23, do të përcaktohet duke përdorur formulën “hyrje e parë, dalje e parë” (FIFO) ose formulën e koston mesatare të ponderuar. Një njësi ekonomike do të përdorë të njëjtën formulë kostoje për të gjithë inventarët me natyrë dhe përdorim të ngjashëm. Për inventarët me natyrë ose përdorim të ndryshëm, mund të justifikohet përdorimi i formulave të ndryshme të koston.**
- 26 Për shembull, inventarët që përdoren në një segment shfrytëzimi mund të kenë për njësinë ekonomike një përdorim që ndryshon nga përdorimi i të njëjtit lloj inventari në një segment shfrytëzimi tjetër. Megjithatë, një diferencë në vendndodhjen gjeografike të inventarëve (ose në rregullat respektive tatimore) në vetvete nuk mjafton për të justifikuar përdorimin e formulave të ndryshme të koston.
- 27 Formula HPDP supozon se artikujt e inventarit të cilët kanë qenë blerë ose prodhuar më parë shiten të parët, dhe për rrjedhojë, në fund të periudhës në inventar mbeten ata artikuj të cilët janë blerë ose prodhuar më vonë. Ndërsa, sipas formulës së koston mesatare të ponderuar, kosto e çdo artikulli përcaktohet nga mesatarja e ponderuar e koston të artikujve të ngjashëm në fillim të periudhës dhe koston së artikujve të ngjashëm të blerë ose të prodhuar gjatë periudhës. Mesatarja mund të llogaritet periodikisht, ose sa herë që bëhet hyrje artikujsh, në varësi të rrethanave të njësisë ekonomike.

Vlera neto e realizueshme

- 28 Kosto e inventarëve mund të mos jetë e rikuperueshme kur inventarët dëmtohen, janë bërë tërësisht ose pjesërisht të vjetëruar ose nëse çmimet e shitjes së tyre kanë rënë. Kosto e inventarëve mund të mos jetë e rikuperueshme nëse janë rritur kostot e çmuara të përfundimit ose kostot e çmuara që duhet të kryhen për realizimin e shitjes. Praktika e zhvlerësimit të inventarëve poshtë koston deri në vlerën neto të realizueshme është në koherencë me pikëpamjen që aktivet nuk duhet të mbahen me shuma mbi ato që pritet të realizohen nga shitja apo përdorimi i tyre.
- 29 Zakonisht, inventarët zhvlerësohen deri në vlerën neto të realizueshme, artikull për artikull. Por, në disa raste mund të jetë më e përshtatshme që artikujt e ngjashëm ose që kanë lidhje të grupohen. I tillë mund të jetë rasti i artikujve të inventarit të cilët i përkasin të njëjtës linje produkti, kanë qëllime apo përdorime përfundimtare të ngjashme, prodhohen e tregtohen në të njëjtën zonë gjeografike dhe praktikisht nuk mund të vlerësohen veças elementëve të tjerë në atë linjë produkti. Nuk është e përshtatshme që inventarët të zhvlerësohen mbi bazën e një klasifikimi të inventarit, për shembull, produktet e gatshme, apo të gjithë inventarët në një segment shfrytëzimi të veçantë.
- 30 Çmuarjet e vlerës neto të realizueshme bazohen në evidencën më të besueshme që ekziston, në kohën kur bëhen këto vlerësime, inventarëve për shumën e që pritet të realizohet. Këto çmuarje marrin në konsideratë luhatjet e çmimit apo të koston që lidhet drejtpërdrejtë me ngjarjet që ndodhin pas mbylljes së periudhës për sa kohë këto ngjarje konfirmojnë kushtet të cilat ekzistojnë në fund të periudhës.
- 31 Çmuarjet e vlerës neto të realizueshme marrin në konsideratë edhe qëllimin për të cilin mbahet inventari. Për shembull, vlera neto e realizueshme e sasisë së inventarit që mbahet për të përmbushur kontratat e shitjes apo të shërbimit të firmës bazohet në çmimin e kontratës. Nëse kontratat e shitjes janë për më pak se sasisë e inventarit të mbajtur, vlera neto e realizueshme e diferencës bazohet në çmimet e përgjithshme të shitjes. Për kontratat e shitjes të firmës që tejkalojnë sasisë e inventarëve të mbajtur ose për kontratat e blerjes të firmës mund të krijohen provizione. Këto provizione trajtohen sipas SNK 37 *Provizionet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara*.
- 32 Materialet dhe furniturat e tjera të cilat mbahen për t'u përdorur në prodhimin e inventarëve nuk zhvlerësohen poshtë koston në qoftë se produktet e gatshme në të cilat do të trupëzohen, pritet të shiten me një çmim që është në ose mbi kosto. Megjithatë, kur një rënie në çmimin e materialeve tregon se kosto e produkteve të gatshme e tejkalon vlerën neto të realizueshme, materialet zhvlerësohen deri në vlerën neto të realizueshme. Në këto rrethana, kosto e zëvendësimit të materialeve mund të jetë matja më e mirë e mundshme e vlerës neto të realizueshme.
- 33 Në çdo periudhë të mëpasshme bëhet një vlerësim i ri i vlerës neto të realizueshme. Kur rrethanat të cilat çuan në zhvlerësimin e inventarëve poshtë koston nuk ekzistojnë më, ose kur ka evidencë të qartë të rritjes së vlerës neto të realizueshme për shkak të rrethanave ekonomike të ndryshuara, shuma e zhvlerësimit rimerret (që do të thotë se kjo rimarrje kufizohet deri në shumën e zhvlerësimit fillestar), kështu që vlera kontabël është më ulëta midis koston dhe vlerës neto të realizueshme të rishikuar. Kjo ndodh për shembull, kur një element i inventarit, që është mbajtur me vlerën neto të realizueshme për shkak se çmimi i tij i shitjes ka rënë, është ende gjendje në një periudhë të mëpasshme dhe çmimi i tij shitjes është rritur.

Njohja si shpenzim

- 34 Kur inventarët shiten, vlera kontabël e tyre do të njihet si shpenzim në periudhën në të cilën njihen të ardhurat përkatëse. Shuma e çdo zhvlerësimi të inventarëve deri në vlerën neto të realizueshme dhe të gjitha humbjet e inventarëve do të njihen si shpenzim në periudhën kur ndodh zhvlerësimi ose humbja. Shuma e ndonjë rimarrje të zhvlerësimit të inventarëve, që vjen nga rritja e vlerës neto të realizueshme, do të njihet si një zbritje e shumës së inventarëve të njohur si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh rimarrja.
- 35 Disa inventarë mund të shpërndahen në llogari të tjera të aktivitetit, për shembull, inventari që përdoret si pjesë përbërëse e aktiveve afatgjata materiale të ndërtuara vetë. Në këtë mënyrë, inventarët të cilët i caktohen një aktiviteti tjetër, njihen si shpenzim gjatë jetës së dobishme të atij aktiviteti.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 36 Në pasqyrat financiare do të jepet informacion shpjegues për:
- (a) politikat kontabël të adoptuara për matjen e inventarëve, përfshirë formulën e kostos të përdorur;
 - (b) vlerën kontabël totale të inventarëve dhe vlerën kontabël sipas klasifikimeve që janë të përshtatshme për njësinë ekonomike;
 - (c) vlerën kontabël të inventarëve të cilët mbahen me vlerën e drejtë minus kostot për shitjen;
 - (d) shumën e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës;
 - (e) shumën e zhvlerësimit të inventarëve të njohur si shpenzim për periudhën, në pajtim me paragrafin 34;
 - (f) shumën e çdo rimarrje të zhvlerësimit, të njohur si zbritje në shumën e inventarëve të njohur si shpenzim për periudhën, në pajtim me paragrafin 34;
 - (g) rrethanat ose ngjarjet që kanë çuar në rimarrjen e një zhvlerësimi të inventarëve, në pajtim me paragrafin 34; dhe
 - (h) vlerën kontabël të inventarëve të vendosur si peng për detyrimet.
- 37 Informacioni për vlerat kontabël të mbajtura në klasifikime të ndryshme të inventarëve dhe shkalla e ndryshimeve në këto aktive është i vlefshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare. Klasifikimet e zakonshme të inventarëve janë mallrat, furniturat e prodhimit, mallrat, prodhimi në proces dhe produktet e gatshme.
- 38 Shuma e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës, e cila shpesh i referohet kostonë së shitjes, konsiston në ato kosto të cilat janë përfshirë më parë në matjen e inventarit të shitur, dhe në shpenzimet e përgjithshme të prodhimit të pashpërndara dhe shumat tej normales të kostove të prodhimit të inventarëve. Rrethanat e njësisë ekonomike mund të justifikojnë edhe përfshirjen e vlerave të tjera, siç janë për shembull kostot e shpërndarjes.
- 39 Disa njësi ekonomike i klasifikojnë shpenzimet sipas natyrës në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes në një mënyrë e cila sjell që shumat e paraqitura të jenë të ndryshme nga kostoja e inventarit e njohur si shpenzim gjatë periudhës. Në këtë rast, njësi ekonomike paraqet kostot e njohura si shpenzim për lëndët e para dhe materialet e konsumit, për përfitimet e punonjësve dhe kosto të tjera së bashku me shumën e ndryshimit neto të inventarëve për periudhën.

Data e hyrjes në fuqi

- 40 Njësia ekonomike do të zbatojë këtë standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 40A [Fshirë]
- 40B [Fshirë]
- 40C SNRF 13, publikuar në maj 2011, ka ndryshuar përkufizimin e vlerës së drejtë në paragrafin 6 dhe ka ndryshuar paragrafin 7. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.
- 40D [Fshirë]

SNK 2

- 40E SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*, i publikuar në maj 2014, ndryshoi paragrafët 2, 8, 29, 37 dhe fshiu paragrafin 19. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 15.
- 40F SNRF 9 i publikuar në korrik 2014 ndryshoi paragrafët 2 dhe ka fshirë paragrafët 40A, 40B dhe 40D. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 9.
- 40G SNRF 16 *Qiratë*, e publikuar në janar 2016, ndryshoi paragrafin 12. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.
- 40H SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafin 39. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur ai zbaton SNRF 18.

Shfuqizimi deklarave të tjera

- 41 Ky Standard zëvendëson SNK 2 *Inventarët* (rishikuar më 1993).
- 42 Ky standard zëvendëson edhe KIS-1 *Qëndrueshmëria—Përdorimi i formulave të ndryshme të kostos për inventarët*.